

VENDIM
Nr. 305, datë 9.5.2012

**PËR PËRBËRJEN E KOMISIONEVE TË REGJISTRIMIT TË PËRGJITHSHËM TË NJËSIVE
EKONOMIKE BUJQËSORE NË QARK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “ç” të nenit 12 të ligjit nr. 10 201, datë 17.12.2009 “Për regjistrimin e përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore”, me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Komisioni i regjistrimit të përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore në qark kryesohet nga kryetari i këshillit të qarkut dhe përbëhet nga:

- | | |
|---|-------------|
| - Prefekti | nënkryetar; |
| - Përgjegjësi i zyrës së INSTAT-it në rrethin qendër qarku | anëtar; |
| - Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë dhe Ushqimit, në qark | anëtar; |
| - Drejtori i Drejtorisë së Policisë së Qarkut | anëtar. |
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha